

BIBLIOTEKA
SHTETIT

398.8


L 95

LULE
MAJI,
MOJ
KOLONJË

*Këngë
popullore*

39
L 95

LULE
MAJI,
MOJ
KOLONJË



*këngë popullore
nga rrethi
i Kolonjës*

Mbledhur dhe përgatitur nga.

VASIL DEDE

PARTI, JE MAL I LARTË

O Parti, je mal i lartë
për ty zemra na këndon,
je besnike e marksizmit
prandaj kurrë nuk gabon.

Me ty jemi kryelartë
si flamuri që valon,
me ty çajmë çdo bllokadë
Enver Hoxhën në timon.

O Parti, je mal i lartë
për ty zemra na këndon,
me ty jemi kryelartë
si flamuri që valon.

Shtikë

SHQIPËRI, SYRI QË S'FJETE...

Shqipëri, syri që s'fjete
s'u theve nga qindra derte
t'u përplasën dallgë, shtete,
kala ishe kala mbete.
Shqipëri, yllin në ballë
krejt fytyra dritëlarë
me argjend, flori të rrallë,
rreze thith një botë mbarë.
Ballëlarta, shtatkalaja
nxjerr mendime të mëdhaja,
rruga jote njeh veç maja.
Ti flamurin nuk e ul
hiq ata ti prapë vur,
ke themelet shkëmb e gur
dhe marksizmin dritë e yll.
Shqipëri, syri që s'fjete

rrezëllin si diell në shkrepje
me Partinë tënde mbete
besnike deri në vdekje.

Kolonjë

E FUQISHME USHTON KËNGA

Sot këtu në Gjirokastrë,
në kalanë madhështore,
e fuqishme ushton kënga
edhe vallja arbërore.

Na ngroh zemrat festivali
në vendlindjen e Enverit
shkëlqen fusha, ndriçon mali
me tërë ngjyrat e ylberit.

Ndizet kënga, dridhet vallja
me hare e me gëzim
për Partinë sokoleshë,
për Enverin kryetrim.

Myzeqarë e malësorë
si vëllezër plot gëzim
zemrat thellë u këndojnë
për Partinë që na prin.

Ersekë

FENER PËR NE

Festë e madhe anembanë
delegatë nga çdo anë
mijëra revolucionarë
po të vijnë, moj Tiranë.
Gaz i madh për Shqipërinë
kudo flet për Partinë,
Kongresi i Shtatë i Partisë
është fener i punëtorisë.
Armiqtë po i kap tmerri
lufton si trim Enveri
si kundër imperializmit
ashtu dhe revizionizmit.
Shtatë kongrese Partie,
shtatë kala trimërie,
shtatë përqafime miqve,
shtatë batare armiqve.

BILBIL—O, KËNDON PËRHERË

Kujtimit të shokut H. Kapo

Vdekjezeza ty të mori
dhëmbja zemrat na i drodhi
rrjedhin ditët ujë kroji
prapë ngrihesh si dragoi.

Ti me ne ku ndizen drita,
ti me ne ku vihen prita,
ti me ne kur hapet dita,
ti te Fierza, te Bistrica...